REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA

www.komuna-kline.org

REPUBLIKA KOSOVA

Pranuar më dt.
Received on
Primljeno dana 10. 12. 2024

| Njësia org. Unit Organ. Jed. | Numër Number Broj | Shtojca Appendix Prilog | |
|---|---|---|---|
| 01 - | 052 - | 41293 / | 24 |

# RAPORT PËR ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË KOMUNËN E KLINËS PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2024

Dhjetor, 2024

# HYRJE

Në pajtim me nenin 25 të LIGJIT NR.08/L-017 PËR AGJENCINË PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT) si dhe në përputhje me "Metodologjinë e Planeve të Integritetit" (https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78702), ku vendimi i miratimit të kësaj metodologjie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më datën 27.07.2023, të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Klinës me datën 18.12.2023, ka miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026. Neni , si përkufizim thotë që Plani i Integritetit – dokumenti i cili përgatitet si rezultat i vetë-vlerësimit të institucionit, të ekspozimit të rrezikut të pranisë dhe zhvillimit të korrupsionit dhe ekspozimit ndaj veprimeve të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i integritetit është një dokument brendshëm dy (2) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Plani rithekson përkushtimin e Komunës së Klinës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të komunës së Klinës. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale. Bazuar në metodologjinë e Planit të Integritetit të hartuar nga Agjencia për parandalimin e Korrupsionit, institucionet publike janë të obliguar të raportojnë në agjenci dy here në vite në lidhje me nivelin e zbatimit të planit. Ky Raport është në përputhje të plot me Metodologjinë e Planit të Integritetit dhe shpjegon në detaje nivelin e zbatimit të këtij planit në Komunën e Klinës.

Komuna e Klinës në vazhdimësi do të bëjë përpjekje të fuqishme për të rritur efikasitetin, trajtimin dhe cilësinë e shërbimeve publike dhe kështu në mënyrë të dukshme dhe të konsiderueshme, përmirësojmë kushtet e jetesës dhe të biznesit për komunitetin lokal. Të gjithë ne jemi përgjegjës të ndërmarrim të gjithë hapat e nevojshëm për të parandaluar

dhe zgjidhur çfarëdo konflikti real, të dukshëm apo potencial të interesit ndërmjet përgjegjësive tona zyrtare dhe çështjeve tona private në të mirë të interesit publik.




## MONITORIMI

Plani i Integritetit i miratuar me vendim të Kryetarit të Komunës së Klinës, të datës 29.12.2024, më numër protokolli 01 nr. 030-43555/23, dhe i cili është hartuar nga grupi punues me vendim të kryetarit nr. 01-112-33894/23, i datës 26.09.2024, linku i vendimit në web:
https://kk.rksgov.net/kline/wpcontent/uploads/sites/15/2023/10/20231016084626.pdf, Kryetari me vendim gjithashtu ka caktuar edhe Zyrtarin përgjegjës për Menaxhimin e Përgatitjes dhe Zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Klinës, më datën 20 gusht 2023, me numër protokolli 01 Nr. 112-33247/2023, (linku i vendimit i publikuar në web faqen zyrtare https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/10/P.-Integritetit.pdf ), i cili do të koordinojë procesin dhe monitorojë zbatimit të tij si dhe duke përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, gjithashtu edhe informatat të cilat janë dhënë nga drejtorit, sektorët. Me qëllim të monitorimit të tij dhe analizës së zbatimit të masave/veprimeve, është hartuar raporti për periudhën janar - dhjetor 2024.

Raporti përfshinë periudhën janar - dhjetor 2024 dhe përfshinë veprimet e ndërmarra në kuadër të fushave: **a).** fushave të përgjithshme të rrezikut dhe **b).** fushave të veçanta të rrezikut, të cilat janë vendosura në planin për Integritet. Andaj, edhe raporti është realizuar përmes informatave plotësuese nga ana e drejtorive. Mbi bazën e këtyre informatave, është arritur që të analizohet dhe vlerësohet gjendja aktuale e zbatimit të masave/veprimeve nga plani i veprimit.

## METODOLOGJIA E MONITORIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR INTEGRITET NË KOMUNËN E KLINËS

Procesi i monitorimit të Planit të Veprimit për Integritet në Komunën e Klinës është zhvilluar përmes një cikli të mirë strukturuar metodash, të cilat përfshijnë hapat në vijim:

**Komunikimi Fillestar**: Njësitë e komunës janë njoftuar përmes një email-i zyrtar lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre në kuadër të Planit të Veprimit për Integritet. Email-i përmbante detaje të plota të planit të veprimit dhe udhëzime për zbatimin e tij. Gjithashtu, është diskutuar në Këshillin e Drejtorëve së bashku me kryetarin e komunës lidhur me obligimet ligjore dhe detyrave apo masave që duhet zbatuar nga Plani Integritetit e që të cilat do të përfshihen në raporte gjashtëmujore dhe vjetore.

**Rikujtimi dhe Ndjekja:** Për të siguruar përmbushjen e detyrimeve, janë dërguar email-e rikujtues njësive përkatëse. Këto email-e kishin për qëllim të inkurajonin plotësimin e raportit mbi zbatimin e Planit të Integritetit. Zyrtari përgjegjës për Menaxhimin e Përgatitjes dhe Zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Klinës, gjithashtu ka mbajtur takime të rregullta nëpër njësi me zyrtarët përkatës për të biseduar, bashkëpunuar si dhe koordinuar lidhur me objektivat dhe qëllimet të përcaktuara në dokumentin e këtij plani. Gjë e cila do të sjellë lehtësira në realizim të aktiviteteve të cilat konsiderohen si të mirinformuara paraprakisht.

**Analiza dhe Raportimi:** Pas marrjes së raporteve të veprimit nga njësitë e komunës, masat dhe veprimet e raportuara u analizuan me kujdes. Në përfundim të analizës, u hartua një raport i plotë për zbatimin e Planit të Integritetit për periudhën janar – dhjetor 2024. Ky raport përmban të dhëna narrative dhe statistikore, duke ofruar një vlerësim gjithëpërfshirës të progresit të arritur.

# TË GJETURAT E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT NË KOMUNËN E KLINËS (JANAR – QERSHOR 2024)

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2024, Komuna e Klinës ka zbatuar një proces të detajuar për implementimin e Planit të Integritetit, i cili përfshiu:

**Fusha të rrezikut të planifikuara; FUSHË E PËRGJITHSHME DHE FUSHË E VEÇANTË.**

**15** fusha të rrezikut; **4 FUSHA TË PËRGJITHSHME**, si dhe **11 FUSHA TË VEÇANTA.**

**43** nën fusha të rrezikut; **Fusha e përgjithshme e rrezikut; 12 nën fusha, Fusha e veçantë e rrezikut; 31 nën fusha.**

**59** masa/veprime të propozuara për zbatim (rekomandime) .

**Rezultatet kryesore të zbatimit, përqindja e zbatimit:**

**Masa/veprime të zbatuara**: **39** masa, që përbëjnë **66.10%** të totalit të propozuar.

**Masa/veprime pjesërisht të zbatuara**: **12** masa, që përbëjnë **20.33%** të totalit të propozuar.

**Masa/veprime të pazbatuara**: **7** masa, që përbëjnë **11.86%** të totalit, për të cilat janë ofruar informata adekuate ose janë vlerësuar si të pazbatuara.

**Detajet sipas fushave të rrezikut:**

1. **Fusha e përgjithshme e rrezikut 4 FUSHA TË PËRGJITHSHME** :

   - ✓ **Masa të propozuara: 23**
   - ✓ **Masa të zbatuara: 21 (91.30% zbatim),**

- ✓ **Masa pjesërisht të zbatuara: 1 (4.34% pjesërisht të zbatuara),**
- ✓ **Masa të pazbatuara: 1 (4.34% të pazbatuara),**
- ✓ **Nën fusha të rrezikut: 12.**

2. **Fusha e veçantë e rrezikut:**

- ✓ **Masa të propozuara: 36**
- ✓ **Masa të zbatuara: 19 (52.77% zbatim),**
- ✓ **Masa pjesërisht të zbatuara: 1 (30.55% pjesërisht të zbatuara),**
- ✓ **Masa të pazbatuara: 6 (16.66% të pazbatuara),**
- ✓ **Nën fusha të rrezikut: 31**

Për të gjitha masat dhe veprimet e zbatimit, si dhe për informacionet shtesë, janë ofruar sqarime të hollësishme në vijim.

*Shtojca 1 – Linçet e vendimeve lidhur me Planin e Integritetit të publikuara në web faqen zyrtare;*

https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/10/20231016084626.pdf

https://kk.rks-gov.net/kline/wp-content/uploads/sites/15/2023/10/P.-Integritetit.pdf

## Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rendisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.

- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.

- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.

- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si  dhe forcimi i sundimit të ligjit.

## MATRICA STANDARDE E MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT TË ZBATIMIT TË PLANIT TE INTEGRITETIT

*Shtojca nr.1 – Matrica;*

| RAPORTI I ZBATIMIT | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT | | | | | | | |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. DREJTIMI DHE MENAXHIMI. | **1.Opinion publik jo i kënaqshëm dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme.**<br><br>**2.Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit.** | 1.Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës.<br><br>2.Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje.<br><br>3.Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit.<br><br>4.Të monitorohet dhe raportohet | 1.Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e drejtorive komunale.<br><br>2.Zyra për Informim në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin dhe Drejtoritë.<br>3. Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e organeve komunale.<br><br>4.Mekanizmat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës. | 1.Në vazhdimësi.<br><br>2.Në vazhdimësi.<br><br>3.Në vazhdimësi.<br><br>4.Në vazhdimësi.<br><br>5.Pas miratimit të | E realizuar.<br><br>E realizuar.<br><br>E realizuar.<br><br>E realizuar. | Web faqja zyrtare; https://kk.rks-gov.net/kline/<br><br>Web faqja zyrtare; https://kk.rks-gov.net/kline/<br><br>Web faqja zyrtare; https://kk.rks-gov.net/kline/<br><br>Email-e, | Gjatë kësaj periudhe kemi pasur probleme të vazhdueshme me funksionimin e ueb faqes zyrtare të komunës.<br><br>Gjatë kësaj periudhe kemi pasur probleme të vazhdueshme me funksionimin e ueb faqes zyrtare të komunës edhe për kundër reagimeve me email në ASHI. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **3.Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit.** | rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit.<br><br>5. Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësime. | 5.Mekanizmat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës. | Planit të Integritetit.<br><br>6. Çdo gjashtë (6) muaj. | **Pjesërisht e realizuar.** | takime dhe koordinime të tjera të brendshme. | Obligime dhe përgjegjësi të shumta të zyrtarëve komunal, të cilët përveç punës të përcaktuar me kontratë që e bëjnë, kanë edhe obligime tjera shtesë me nga 2 apo 3 vendime të tjera. |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| **2. POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE.** | **1.Profesionalizmi dhe kompetenca e pamjaftueshme e të punësuarve.** | 1.Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit.<br><br>2. Të bëhet analiza e nevojave për trajnime. | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Linku nga web faqja zyrtare për njoftimet e rregullta të konkurseve dhe procedurave, vjegëza; Konkurset dhe Njoftimet. | Respektimi i afatit për caktimin e testit me shkrim në DMZP. |
| | **2.Mos zbatimi dhe monitorimi** | | Kryetari i Komunës, | Në vazhdimësi. | E realizuar. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **i Kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit.** | 3. Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive. | | | Hartohet plani i trajnimeve për një vit. I publikuar në Sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. | Mbajtja e testimit me shkrim në Prishtinë. |
| | | 4. Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura. | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Plani i trajnimeve. | |
| | **3. Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues dhe stafin tjetër të komunës.** | 5. Monitorimi i zbatimit të obligimeve dhe të drejtave sipas Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive, eprorët. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Email-e, Njoftime dhe deklarate nënshkruar nga Zyrtarët Publik mbi leximin e Kodit të Etikës. | |
| | | 6.Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive, eprorët. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Email-e dhe në kopje fizike. | |
| | **4. Mungesa e informimit dhe** | | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **mos raportimit të dhuratave nga qytetarët tek punëtorët e Komunës (neni 17 dhe 18 i Rregullore (QRK - Nr. 04/2015 Për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës).** | 7. Njësisë për Burime Njerëzore krijon një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuara nga nëpunësit;<br>Të informohet stafit për rregullat e pranimit të dhuratave. | Njësia e Burimeve Njerëzore.<br>Njësia e Burimeve Njerëzore. | Në vazhdimësi. | E realizuar.<br>E realizuar. | Email-et zyrtare të dërguara.<br>Vendim i datës 11.10.2021, me numër protokolli: 02 Nr. 466-36806/2021. | |
| | | 8. Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme. | Njësia e Burimeve Njerëzore. | Në vazhdimësi.<br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br>E realizuar.<br>E realizuar. | | |
| | **5. Niveli i pamjaftueshëm i ndërgjegjësimit të punonjësve për raportimin e korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme** | 9. Të gjithë nëpunësit publik të | Njësia e Burimeve Njerëzore. | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **brenda institucionit.** | punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohet, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësin përkatëse. | | Në vazhdimësi. | | | |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| 3. PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE. | **1.Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal.**<br><br>**2.Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent.** | 1. Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit.<br><br>2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit.<br>3. Raportim i rregullt për | Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik.<br><br>Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me Njësinë e Burimeve Njerëzore. | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br><br>E realizuar. | Web faqja zyrtare, të shikohet linku i vjegëzës Konsultimet Publike, në kuadër të cilës janë të publikuara dokumentet kryesore që lidhen me pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit. Mund | Mos pjesëmarrja e numrit të madh të grave të komunës së Klinës dhe personave me nevoja të veçanta.<br><br>Mos identifikimi i nevojave të grave dhe personave me |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shpenzimet buxhetore.<br><br>4. Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës.<br><br>5. Të sigurohet mbikëqyrja e mbi zbatimin e buxhetit nga KPF.<br><br>6. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit. | Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik.<br><br>Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me Zyrën për informim.<br><br>Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik.<br><br>Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik. | Çdo tre (3) muaj.<br><br>Çdo tre (3) muaj.<br><br>Çdo tre (3) muaj.<br><br>Çdo tre (3) muaj. | E realizuar.<br><br>E realizuar.<br><br>E realizuar.<br><br>E realizuar. | të shihet Plani i Konsultimeve dhe grupet e interesit të tragetuara.<br><br>Web faqja zyrtare, të shikohet linku i vjegëzës Buxheti, në kuadër të së cilës janë të publikuara raportet e rregullta të shpenzimeve buxhetore dhe atë në tre formate të përpunimit të të dhënave WORD, EXCEL dhe PDF. | nevoja të veçanta në buxhet. |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| 4. RUAJTJA DHE SIGURIA | **1.Siguria e pamjaftueshme** | 1. Zhvillimi dhe miratimi i | Kryetari i Komunës, | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Nuk ka. | Mos kujdesi i punonjësve |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E TË DHËNAVE DHE DOKUMENT ACIONIT. | **e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare.**<br><br>**2. Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit.** | procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative.<br><br>2. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikut nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara.<br><br>3. Zbatimi dhe monitorimi i Kodit të Etikes. | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK.<br><br>Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK.<br><br>Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK. | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | **E pa realizuar.**<br><br>E realizuar. | Nuk ka.<br><br>Nuk ka email-e, apo caktim të takimeve me të punësuarit lidhur me informim të rrezikut nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuar a. | ndaj email-eve spam.<br><br>Mos organizimi i trajnimeve specifike për përdorimin e teknologjisë së informimit. |

**FUSHAT E VEÇANTA TË RREZIKUT**

| Fusha e Rrezikut | Përshkrimi i Rrezikut | Masa e propozuar | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizmit | Niveli i realizmit | Mjetet e verifikimit | Fusha e Rrezikut |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. AUDITIMI I BRENDSHËM. | **1.Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti.**<br><br>**2. Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve**<br><br>**3. Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësisë së Auditimit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit dhe Kryetarit.** | 1. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve në drejtoritë përkatëse.<br><br>2. Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit.<br><br>3. Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. | Kryetari i Komunës, drejtorë të drejtorive dhe udhëheqës të njësive.<br><br>Njësia e Auditimi të Brendshëm.<br><br>Zyrtari i caktuar nga Kryetari i Komunës për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br><br>**Pjesërisht e realizuar.**<br><br>**Pjesërisht e realizuar.** | Email-e dhe takime.<br><br>Agjenda të caktuara për akordim dhe planifikim apo realizim të planit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. | Obligime dhe përgjegjësi të shumta të zyrtarëve komunal, të cilët përveç punës të përcaktuar me kontratë që e bëjnë, i cili ka edhe obligime shtesë mbikëqyrjen e rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit. |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **6.PROKURIMI PUBLIK.** | **1.Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit.**<br><br>**2.Mos transparenca dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme e Prokurimit Publik.**<br><br>**3. Menaxhimi joefikas i kontratave/ Projekteve.** | 1.Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë.<br><br>2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik.<br><br>3. Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale. | Njësia e Prokurimit Publik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Njësia e Prokurimit Publik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Njësia e Prokurimit Publik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Kryetari i Komunës së | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br><br>**Pjesërisht e realizuar.**<br><br>**Pjesërisht e realizuar.**<br><br>E realizuar. | Zyra e Prokurimit Publik ka rritur kapacitetet e saja me staf shtesë.<br><br>Email-e dhe takime.<br><br>Agjenda të trajnimeve.<br><br>Kryetari i Komunës tanimë ka krijuar Sektorin/Zyrën për Menaxhimin e Projekteve me tre (3) Inxhinier apo ekspert të fushës. | Numri i vogël i ekspertëve të punësuar me kontratë të përkohshme kundrejt kontratave dhe projekteve.<br><br>Mungesa e trajnimeve në fushën e menaxhimit të kontratave publike si dhe Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/pr ojektit. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4. Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit.<br><br>5. Krijimi i Sektorit për Menaxhimin e Projekteve dhe Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit. | Klinës dhe Njësia e Prokurimit Publik dhe Njësia e Burimeve Njerëzore. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | | |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| 7. ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL. | **1.Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve Strategjike për Zhvillim Ekonomik Lokal.** | 1. Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës. | Kryetari i Komunës së Klinës dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik Lokal. | Çdo gjashtë (6) muaj.<br><br>Në vazhdimësi. | **Pjesërisht e realizuar.** | Web faqja zyrtare e Komunës së Klinës. Publikimi në linkun, vegëza tek DOKUMENTE | Obligime dhe përgjegjësi të shumta të zyrtarëve komunal, të cilët përveç punës të përcaktuar |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | https://kk.rks-gov.net/kline/category/dokumente/ | me kontratë që e bëjnë, kanë edhe obligime tjera shtesë me nga 2 apo 3 vendime të tjera. |
| | **3. Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për zhvillimin ekonomik lokal.** | 2. Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal. | Kryetari i Komunës së Klinës dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe drejtoritë tjera ku ka ndarje të subvencioneve. | Në vazhdimësi. | **Pjesërisht e realizuar.** | Raport apo ndonjë dëshmi tjetër të rishikimit dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës. | Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 – 2029 është punuar nga Kompania Hartuese me ekspertë, andaj do të jetë e vështirë të monitorohet dhe rishikohet nga Zyrtarët e Shërbimit Civil. |
| | | 3. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal. | | | E realizuar. | | |
| | **4. Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të Zhvillimit Ekonomik Lokal.** | 4. Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal. | Kryetari i Komunës së Klinës dhe Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe Njësia e Burimeve Njerëzore. | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | **E parealizuar.** | Vendimi i themelimit të komisionit për ndarjen e subvencioneve për OJQ, në web faqen zyrtare: https://kk.rks-gov.net/kline/category/konkurset-e-njoftimet/ | https://kk.rks-gov.net/kline/wp- |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Komuna e Klinës e ka të Miratuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024 – 2029. | content/uploads/sites/15/2024/02/Strategjia-per-Zhvillim-Ekonomi-Lokal-per-Komunen-e-Klines-2024-2029.pdf |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| **8. PLANIFIKIMI URBAN DHE MBROJTJA E MJEDISIT.** | **1.Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural.**<br><br>**2. Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural.** | 1.Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullativës së brendshme.<br><br>2.Të sigurohet trajnimi specifik i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural. | Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes | 12 muaj.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br><br>**Pjesërisht e realizuar.**<br><br>E realizuar. | Janë hartuar raporte periodike mbi aktivitetet e planifikimit urban.<br><br>Raporti vjetor i Punës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.<br><br>Komuna e Klinës, në web faqen e saj zyrtare ka | Mos planifikim dhe mundësi e rritjes së stafit në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.<br><br>Ngarkesë në web faqen zyrtare për mundësinë e publikimi të raporteve të |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **3.Mos publikimi i listës së dhënieve të lejeve ndërtimore në territorin e komunës së Klinës.**<br><br>**5.Raportet e pranimeve teknike të projekteve infrastrukturore.**<br><br>**6. Mos publikimi i listës së kontratave apo kontratave veç e veç në web faqen zyrtare të Pronave Komunale për Dhënie nën Shfrytëzim më pak se një vit.** | 3.Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural.<br><br>4.Të publikohen në vazhdimësi në web faqen zyrtare Lista e dhënies së Lejeve Ndërtimore për periudha të caktuara kohore. | së Mjedisit dhe Zyra për Informim.<br><br>Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra për Informim si dhe Zyrtari Përgjegjës për Konsultim Publik. | Në vazhdimësi.<br><br>Çdo tre (3) muaj. | **Pjesërisht e realizuar.** | publikuar në vazhdimësi listën e dhënies së lejeve ndërtimore të lëshuara për periudha të caktuar tre (3) mujore;<br><br>https://kk.rks-gov.net/kline/category/lejet-ndertimore/<br><br>Komuna e Klinës bazuar në RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES NE SHFRYTËZIM ME PAK SE NJË VIT TË PRONËS SË | pranimeve teknike të projekteve infrastrukturore. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | PALUAJTSHME TË KOMUNËS, ka publikuar listën e pronave Komunale për Dhënie nën Shfrytëzim më pak se një vit; https://kk.rks-gov.net/kline/pronat-komunale/ | |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| **9. MIRATIMI I RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM) DHE PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2024-2032.** | **1.Shqyrtimi dhe hartimi i RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM), PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË KLINËS 2024-2032.** | 1.Të ketë një procedurë konstruktive lidhur me konsultimin publik të VSM-ës.<br><br>2.Raporte profesionale të konsultimit publik, përfshirjes së kontributit të | Kuvendi Komunal Klinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Kuvendi Komunal Klinë, | 12 muaj.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi. | E realizuar.<br><br>E realizuar. | RAPORTI NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR (VSM). | Organizimi i numrit të madh të takimeve për RAPORTIN E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR (VSM), PËR PLANIN ZHVILLIMOR TË |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2. Hartimi konstruktiv i RAPORTIT NGA PROCESI I ORGANIZIMIT TË KONSULTIMIT PUBLIK PËR VLERËSIM STRATEGJIK MJEDISOR (VSM).**<br><br>**4.Hartimi dhe Konsultimi Publik i PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2024-2032.**<br><br>**5.Miratimi i PLANIT ZHVILLIMOR** | qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit në VSM.<br><br>3.Të ketë një procedurë konstruktive dhe të duhur ligjore lidhur me konsultimin publik të PZHK-ës.<br><br>4.Raporte profesionale të konsultimit publik, përfshirjes së kontributit të qytetarëve dhe grupeve tjera të interesit në PZHK. | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Zyra për Informim.<br><br>Kuvendi Komunal Klinë, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyra për Informim si dhe Zyrtari Përgjegjës për Konsultim Publik. | Në vazhdimësi. | **E parealizuar.**<br><br>**E parealizuar.** | Procedurat e konsultimit publik për VSM;<br><br>https://kk.rks-gov.net/kline/category/konsultimet-publike/?page=9 | KOMUNËS SË KLINËS 2024-2032, si dhe PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL 2024-2032.<br><br>Mungesa e ekspertëve të profilizuar në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për hartimin e këtyre dy dokumenteve strategjike të cilët to të luanin rol kyç në zbatimin dhe monitorimin e tij të mirëfilltë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **KOMUNAL 2024-2032.** | | | | | | |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| 10.INSPEKTIMET | **1.Standardet ndërtimore dhe Kontrolli,**<br><br>**2.Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimit,**<br><br>**3. Mungesa e kapaciteteve të Inspektorëve të Ndërtimit.**<br><br>**4. Mungesa e planifikimit të** | 1.Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut.<br><br>2.Organizimi i trajnimeve profesionale dhe specifike për inspektoret.<br><br>3.Mundësia e hartimit të një plani të brendshëm | Drejtoria e Inspektoratit, Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Kryetari i Komunës, Drejtoria e Inspektoratit, Njësia e Burimeve Njerëzore.<br><br>Drejtoria e Inspektoratit. | Në vazhdimësi.<br><br>Në vazhdimësi.<br><br>Në bazë të nevojave për shtim/rritje të stafit. | E realizuar.<br><br>E realizuar.<br><br>**E parealizuar.** | Raportet e punës në kuadër të drejtorisë.<br><br>Procesverbalet e vizitave.<br><br>Vendimet nga vizitat dhe inspektimet në teren. | Obligime dhe përgjegjësi të shumta të Inspektorëve komunal, të cilët përveç punës të përcaktuar me kontratë asistojnë kolegët në inspektime specifike.<br><br>Pasi që në drejtorinë e Inspektoratit vizitat në teren janë të paparashikuar dhe në bazë të |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **duhur të inspektimeve.** | të inspektimeve në teren. | | | | | emergjencës dhe kërkesave është e vështirë të bëhet një planifikim i duhur. |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |
| 11. ARSIMI PUBLIK. | **1.Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor.** | 1.Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij. | Drejtoria e Arsimit. | Në vazhdimësi. | E realizuar. | Raportet e vizitave dhe inspektimit. | Obligime dhe përgjegjësi të shumta të zyrtarëve komunal, të cilët përveç punës të përcaktuar me kontratë që e bëjnë, kanë edhe obligime tjera shtesë me nga 2 apo 3 vendime të tjera. |
| **Fusha e Rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizmit** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
